

KONTRATE
SHIT-BLERJE KUOTASH

Sot, më datë 10.11.2021 (dymijë e njëzet e një) në selinë e shoqërisë "LION CONSTRUCTION" shpk, me NUIS: L62309009J në adresën: Rr. "Dervish Hima", Pallati "Ambasador 3", Kati 14, Ap. 111, Tiranë, u paraqitën palët e mëposhtëme, të cilat redaktuan këtë kontratë shit-blerje kuotash me termat e mëposhtëme:

Z. Bardhjus BUSHAJ, atësia Luan, i datëlindjes 10.05.1982, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, beqar, mbajtës i Leternjoftimit Nr. 034162474 dhe Nr. personal I20510034N, **referuar me poshte si "Shitesi"**;

dhe

Z. Erion GINA, atësia Agim, i datëlindjes 24.04.1984, lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, beqar, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Leternjoftimit Nr. 035132918 dhe nr.personal I40424036G, **referuar me poshte si "Bleresi"**.

MEQENESE ekzistojne faktet:

Z. Bardhjus BUSHAJ, eshte ortak i vetem i shoqerise "LION CONSTRUCTION" SHPK, shoqeri tregtare e te drejtes Shqiptare, me NIPT L62309009J, dhe zoteron 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 100% te kapitalit te shoqerise,

Z. Bardhjus BUSHAJ, deshiron te shes nje kuote qe perfaqeson (50%) te kontributeve qe zoteron ne shoqeri, ortakut te ri, Z. Erion GINA, sipas kushteve te meposhtme.

Z. Erion GINA deshiron te bleje nga Bardhjus BUSHAJ nje kuote qe perfaqeson (50%) te kontributeve te zoteruara prej tij ne shoqerine "LION CONSTRUCTION" SHPK, sipas kushteve te meposhtme.

Bien dakord dhe shprehin vullnetin e tyre për të lidhur këtë kontratë me kushtet dhe termat e mëposhtëme:

Neni 1

Qellimi i kontrates

-Qellimi i kesaj kontrate eshte transferimi i pronesise te nje kuote qe perfaqeson (50%) te kontributeve ne kapitalin e shoqerise nga shitesi tek bleresi.

-Kjo kontrate sherben per percaktimin e kriterëve, procedurave dhe menyres se tranferimit te pronesise dhe pageses perkatese lidhur me kete transferim.

-Ne percaktim te kushteve, palet konsiderojne te ligjshme permbajtjen e saj dhe marrin persiper te ekzekutojne veprimet e tyre brenda kushteve te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Objekti i kontrates

-Nepermjet kesaj kontrate, shitesi transferon ne favor te bleresit nje kuote qe perfaqeson (50%) te kontributeve te zoteruara prej shitesit ne shoqeri, si me poshte te percaktuara.

- *Z. Bardhjus BUSHAJ shet 1 (nje) kuote qe perfaqeson (50%) te kontributeve qe zoteron ne shoqeri, ortakut te ri, Z. Erion GINA.*

Neni 3

Çmimi dhe menyra e pagimit

-Të dyja palët kanë rënë dakort midis tyre që çmimi i shitjes të një kuote që përfaqëson (50%) kontributeve që shitësi transferon në favor të blerësit do të jetë në total **ALL 8.613.490 Leke** (tete miliona e gjashtëqind e trembedhjetë mijë e katërqind e nentëdhjetë leke).

-Shuma ALL 8.613.490 (tete miliona e gjashtëqind e trembedhjetë mijë e katërqind e nentëdhjetë leke) është likuaduar me veprime bankare nga pala blerëse tek pala shitëse.

Neni 4

Pergjegjesite dhe garanci te paleve

Shitësi nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash garanton si më poshtë:

- a) se është i vetmi titullar i ligjshëm i kontributeve që po transferohen me këto kontrate shitje;
- b) se kontributi monetar i derdhur prej tij për zoterimin e kuotave, objekt të kësaj kontrate shitje ben pjesë në pasuritë vetjake në referim të nenin 77 të Kodit të Familjes në fuqi.
- c) se kontributet objekt shitje janë plotësisht të lira nga çdo barrë, detyrim, të drejta reale apo çdo lloj kufizimi tjetër.
- d) se transferimi i këtyre kontributeve në drejtim të blerësit është marrë në pajtim të plote me ligjin tregtar në fuqi dhe dispozitat statutore.
- e) se shoqëria ka zhvilluar aktivitetin e saj në konformitet me ligjin;
- f) shoqëria nuk ka detyrime financiare të pashlyera apo aq me tepër të padeklaruar ndaj institucioneve shtetërore apo personave të tretë fizik apo juridik, me përjashtim të atyre, të cilat janë të pasqyruara në kontabilitet të shoqërisë dhe që i janë bërë të ditura pa lëshuar blerëse përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

Blerësi nëpërmjet kësaj kontrate për shitje kuotash deklaron se është në dijeni që mbi kuotat e shoqërisë "LION CONSTRUCTION" sh.p.k është vendosur një barrë siguroese e regjistruar në favor të "Banka e Tiranës" sh.a mbi këtë kuotë, e cila siguron shlyerjen e kredisë bankare që Kredimarrësi, shoqëria "Lion Construction" sh.p.k ka marrë pranë Tirana Bank sipas marrëveshjes siguroese Nr. 2488 Rep, Nr. 1237 Kol, datë 25.06.2020 noter Alket Mançka.

Për sa më sipër Blerësi merr përsipër se edhe pas fitimit të pronësisë mbi këtë Kuotë, kjo do të vazhdojë të mbartë barrën siguroese ekzistuese të regjistruar në Regjistrin e Barrave Siguroese në favor të Tirana Bank, duke mos çenuar të drejtat tashmë të fituara prej Tirana Bank.

NENI 5

Efektet e kontrates

-Kjo kontrate ka fuqinë e ligjit për palët nga momenti i nënshkrimit të saj dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim dypalësh.

-Kontrata ka efekt për palët e treta në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Për më shumë qartësi, palët deklarojnë që detyrimet e shitësit sa më sipër, janë solidale ndërmjet tyre.

NENI 6

Informacioni konfidencial

-Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhenat dhe çdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këto kontrate.

NENI 7

Transferimi i të drejtave

-Menjëherë mbas nënshkrimit të paleve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga blerësit pranë regjistrin tregtar të QKB.

-Palët me vullnet të lire bien dakord që pavarësisht mënyrës së pagimit të çmimit nga bleresi, 1 (nje) kuote qe perfaqeson 50% te kapitalit te shoqerise te regjistrohet ne pronesi te pales blerese qe me nenshkrimin e kesaj kontrate.

-Me nenshkrimin e kesaj kontrate, kapitali i shoqerise do te jete i ndare ne 2 (dy) kuota, me pjesmarrje te ortakeve ne kapitalin e shoqerise si me poshte:

- **Z. Bardhjus BUSHAJ**, ortak i shoqerise, zoterues i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise me vlerë të përgjithshme prej 8.613.490 lekë (tete milione e gjashteqind e trembedhjete mije e katerqind e nentedhjete leke) ;

- **Z. Erion GINA**, ortak i shoqerise, zoterues i 1 (nje) kuote, qe perfaqeson 50 % te kapitalit te shoqerise me një vlerë të përgjithshme prej 8.613.490 lekë (tete milione e gjashteqind e trembedhjete mije e katerqind e nentedhjete leke);

NENI 8

Ligji i aplikueshem dhe Gjykata kompetente

-Kontrata eshte hartuar ne perputhje me Legjislacionin tregtar ne fuqi ne 4 kopje me fuqi te njejte ligjore.

-Bleresi dhe shitesi angazhohen te bejne cdo perpjekje per zgjidhjen e mosmarreshjeve apo konfliktet te mundshme qe mund te krijohen midis tyre, lidhur me kete kontrate nepermjet negociemeve te drejteperdrejta.

-Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreshjeve apo konflikteve midis tyre, ceshtja do ti nenshtrohet juridiksionit gjyqesor, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

PALET KONTRAKTORE

SHITESI

Z. Bardhjus BUSHAJ



BLERESI

Z. Erion GINA

